

# **NJOFTIME FITUESI ANKANDI**

## **BASHKIA ELBASAN** NJOFTIM FITUESI

Për:

OE "Blaed Trade" sh.p.k.

"Blaed Trade" sh.p.k, me NIPT K98423503J, me adresë: Lezhe Zejmen TRESH Rruga "Bakaj", Magazine me Nr.pasurie 116/68, zona kadastrale Nr.3641.

Procedura e ankandit: "Ankand i Hapur".

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: Shitja në ankand e 70 % të aksioneve të Shoqërisë Tregtare Sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" Sh.A, me vlerë fillestare 13,838,650 (trembëdhjetëmilion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri].

Njoftojmë se në këtë procedurë të zhvilluar më datë 03.04.2024 ora 10.00, kanë qenë pjesëmarrës këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE "Blaed Trade" sh.p.k. me NIPT K98423503J

Vlera e ofruar është prej 13.850.000 (trembëdhjetëmilion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. OE "ALComm Solutions" sh.p.k me NIPT M01427004J

Vlera e ofruar është prej 13.838.650 (trembëdhjetëmilion e tetëqind e tridhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.

Ofertues të s'kualifikuar OE "ALComm Solutions" sh.p.k per arsyet e meposhtme:

Kandidati "ALComm Solutions" sh.p.k. pjesmarrës në ankand, nuk plotëson dokumentacionin për kualifikim sipas kërkesave të dhëna në dokumentat e ankandit:

Per arsye se:

1) Dokumenti bankar i cili verteton gjendjen monetare i leshuar nga BKT dhe me nr. Prot 433 datë 28.03.2024 eshte i leshuar ne nje date me te hershme sesa ajo e percaktuar ne piken 13 te kritereve te vecanta per kualifikim, ku parashikohet se : Vertetim/e nga Banka/at per gjendjen e mjeteve monetare. Te kete aktive likuide ( mjete monetare) jo me pak se vlera fillestare e ankandit, te vertetuar me konfirmime zyrtare nga Bankat, per nje date jo me te hershme se 5 dite kalendarike nga data e hapjes se ofertave, te shoqeruara me dokumentacionin perkates qe provon burimin e mjeteve monetare.

2) Dokumenti i paraqitur per te vertetuar shlyerjen e detyrimeve te energjise elektrike te maturuara eshte paraqitur kopje e panoterizuar. Cka bie ne kundersizim me rregullat e percaktuar te dokumentaave te ankandit ku thuhet: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si *kushte për skualifikim*.

Bazuar ne Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar; neni 36 në pikat 3;5:

3. Autoriteti shitës, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson se oferta është e vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e ankandit dhe në dokumentet e ankandit.

5. Autoriteti shitës nuk e pranon një ofertë:

- a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;
- b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, të bërë sipas pikës 2 të këtij neni;
- c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit;
- ç) në rastet e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, (pika 5, germa “b” e Kreut V), i ndryshuar; pikat 5.3 germa ; pika 5.3 germa ç) Pas mbylljes së seancës publike, njësia e ankandit verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, të përcaktuara në dokumentet e ankandit dhe kriterin e vleresimit. Nëse është e nevojshme, njësia e ankandit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të reflektuara në proceverbalin e ankandit. Bazuar në ofertat e pranuar, njësia e ankandit harton klasifikimin përfundimtar duke renditur ofertat me çmimet më të larta deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes dhe e komunikon atë në kohën e përcaktuar.

*Dhe për arsyet e mesiperme subjekti “ALComm Solutions” sh.p.k. skualifikohet nga procedura e ankandit.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: OE “Blaed Trade” sh.p.k. me NIPT K98423503J, me adresë: Lezhe Zejmen TRESH Rruga "Bakaj", Magazine me Nr.pasurie 116/68, zona kadastrale Nr.3641; se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 14.127.000 (katërmëdhjetë milion e njëqind e njetzet e shtatë mijë) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Elbasan, me adresë: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç parashikohet në dokumentat e ankandit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 39 të ligjit nr. 9874, date 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.04.2024.

Ankesa: Nuk ka pasur.